

GJYKATA THEMELORE NE PRISHTINË
DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA
PKR.Nr.1046/13
18 Dhjetor 2014

[Aktgjykimi i publikuar mund të mos jetë i formës së prere dhe mund të jetë objekt i ankesës në bazë të ligjit të aplikueshëm.]

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti i krimeve të rënda, me trupin gjykues të përbërë nga kryetari i trupit gjykues, gjyqtari i EULEX-it Malcolm Simmons dhe anëtarët e trupit gjykues, gjyqtarja kosovare Suzana Çerkini dhe gjyqtarja e EULEX-it Mariola Pasnik, me asistencën e procesmbajtësit Nuhi Shala, në çështjen penale kundër:

1. N.V.

Emri i babait: XXX
Ditëlindja: XXX
Vendlindja: Sarajevë, BeH
Gjinia: Femër
Adresa: XXX, Prishtinë, Kosovë
Shtetësia: Gjermani
Masat kufizuese: Në paraburgim prej datës 14 nëntor 2013

E akuzuar me aktakuzën e Zyrës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë PP 898-4/2012 të datës 7 nëntor 2013, e ndryshuar me Aktvendimin e kryetarit të trupit gjykues PKR.Nr.1046/13 të datës 3 shkurt 2014 dhe me Aktvendimin e Gjykatës së Apelit PN 97/14 të datës 27 mars 2014, për këto vepra penale:

Krim i organizuar, sipas nenit 274, paragrafët (1), (3) dhe (7) të Kodit Penal të Kosovës (në tekstin më poshtë “KPK”) të vitit 2003, (tani e sanksionuar me nenin 283 KPK i vitit 2013), në bashkëkryerje (në bazë të nenit 23 të KPK i vitit 2003 [Neni 31 KPK i vitit 2013]);

Shpërlarje e parave, nga neni 32 paragrafi (2) nënparagrafet (2.1) (2.4) dhe (2.5) të Ligjit mbi parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit të vitit 2010, në bashkëkryerje;

Mashtrim, nga neni 261(1) dhe (2) të KPK të vitit 2003 (tani i sanksionuar me nenin 335 të kpk të vitit 2013);

Shmangie nga tatimi, nga neni 63 (1), (2) (2.1), (3) dhe (4) të Ligjit mbi Administratën tatimore dhe procedurat të vitit 2010 (ATP);

Keqpërdorim i besimit, nga neni 269 KPK 2003, (tani e sanksionuar me nenin 342 KPK 2013);

2. **F.B.**

Emri i babait: XXX
Datëlindja: XXX
Vendlindja: Pejë, Kosovë
Gjinia: Mashkull
Adresa: XXX, Prishtinë, Kosovë
Shtetësia: Kosovë
Masat kufizuese: Në arrest shtëpiak nga 14 nëntori 2013

I akuzuar në aktakuzë për këto vepra penale:

Krim i organizuar, nga neni 274, paragrafët (1), (3) dhe (7) i Kodit penal të Kosovës KPK 2003 (neni 283 KPK 2013), në bashkëkryerje;

Shpërlarje e parave, nga neni 32, paragrafët 2.1, 2.2, 2.4 dhe 2.5 të Ligjit mbi parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit të vitit 2010;

Shmangie nga tatimi, nga neni 63 (1), (2) (2.1) dhe (2.5), (3) dhe (4) të Ligjit mbi Administratën tatimore dhe procedurat 2010 (tani e tutje “ATP”);

3. B.B.

Emri i babait: XXX
Datelindja: XXX
Vendlindja: XXX, Istog, Kosovë
Gjinia: Mashkull
Adresa: XXX, Istog, Kosovë
Shtetësia: Kosovë
Masat kufizuese: Në arrest shtëpiak nga 14 nëntori 2013

I akuzuar në aktakuzë për këto vepra penale:

Krim i organizuar, nga neni 274 (1), (2) (4) dhe (7) të KPK 2003 (neni 283 KPK 2013);

Shpërlarje parash, nga neni 32, paragrafët 2.1, 2.2, 2.4 dhe 2.5 të Ligjit mbi parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit të vitit 2010;

4. E.D.

Emri i babait: XXX
Datelindja: XXX
Vendlindja: Prishtinë, Kosovë
Gjinia: Mashkull
Adresa: XXX, Prishtinë, Kosovë
Shtetësia: Kosovë

I akuzuar në aktakuzë për këto vepra penale:

Krim i organizuar, nga neni 274(1), (2), (4) dhe (7) KPK 2003 (neni 283 KPK 2013);

Shpërlarje parash, nga neni 32, paragrafët 2.1, 2.2, 2.4 dhe 2.5 të Ligjit mbi parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit të vitit 2010;

Shmangie nga tatimi, nga neni 63 (1), (2) (2.1) dhe (2.5), (3) dhe (4) të Ligjit mbi Administratën tatimore dhe procedurat 2010 (tani e tutje “ATP”);

5. I.F.

Emri i babait: XXX
Datelindja: XXX
Vendlindja: XXX, Klinë
Gjinia: Mashkull
Adresa: XXX, Pejë, Kosovë
Shtetësia: Kosovë

I akuzuar në aktakuzë për këto vepra penale:

Krim i organizuar, nga neni 274, paragrafët (1), (2), (4) dhe (7) të KPK 2003 (neni 283 KPK 2013);

Shpërlarje parash, nga neni 32, paragrafët 2.1, 2.2, 2.4 dhe 2.5 i Ligjit mbi parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit të vitit 2010;

Shmangie nga tatimi, nga neni 63 (1), (2) (2.1), (3) dhe (4) i Ligjit mbi administratën tatimore dhe procedurat (ATP);

6. N.T.

Emri i babait: XXX
Datelindja: XXX
Vendlindja: Prizren, Kosovë
Gjinia: Mashkull
Adresa: XXX, Rahovec, Kosovë
Shtetësia: Kosovë

I akuzuar në aktakuzë për këto vepra penale:

Krim i organizuar, nga neni 274, paragrafët (1), (2), (4) dhe (7) KPK 2003 (neni 283 KPK 2013);

Shpërlarje parash, nga neni 32, paragraf 2.1, 2.2, 2.4 dhe 2.5 të Ligjit mbi parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit të vitit 2010;

Shmangie nga tatimi, nga neni 63 (1), (2) (2.5), (3) dhe (4) i Ligjit mbi administratën tatimore dhe procedurat 2010 (ATP);

7. J.B.

Emri i babait: XXX
Datelindja: XXX
Vendlindja: XXX, Podujevë, Kosovë
Gjinia: Mashkull
Adresa: XXX, Podujevë, Kosovë
Shtetësia: Kosovë

I akuzuar në aktakuzë për këto vepra penale:

Pranimi i sendeve të vjedhura, nga neni 272 (1) dhe (2) KPK 2003 (neni 345 KPK 2013)

Shmangie nga tatimi, nga neni 63 (1), (2) (2.1), (3) dhe (4) i Ligjit mbi administratën tatimore dhe procedurat 2010 (ATP);

8. S.S.

Emri i babait: XXX
Datëlindja: XXX
Vendlindja: XXX, Deçan, Kosovë
Gjinia: Mashkull
Adresa: XXX, Deçan, Kosovë

Shtetësia: Kosovë

I akuzuar në aktakuzë për këto vepra penale:

Pranimi i sendeve të vjedhura, nga neni 272 (1) dhe (2) KPK 2003 (neni 345 KPK 2013);

Shmangie nga tatimi, nga neni 63 (1), (2) (2.1), (3) dhe (4) i Ligjit mbi administratën tatimore dhe procedurat 2010 (ATP);

9. H.S.

Emri i babait: XXX
Datëlindja: XXX
Vendlindja: XXX, Pejë, Kosovë
Gjinia: Mashkull
Adresa: XXX, Pejë, Kosovë
Shtetësia: Kosovë

I akuzuar në aktakuzë për këto vepra penale:

Shmangie nga tatimi, nga neni 63 (1) dhe (4) i Ligjit mbi administratën tatimore dhe procedurat 2010 (ATP);

Pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor publik më 22 maj 2014, 3, 5, 6, 9, 12 qershor 2014, 3, 4, 8, 9, 15, 29, 30, 31 korrik 2014, 1, 9, 30 shtator 2014, 1, 2, 28, 30 tetor 2014, 4, 11, 12, 17 nëntor 2014, 2 dhe 18 dhjetor 2014,

Pas këshillimit të trupit gjykues dhe votimit të mbajtur më 18 dhjetor 2014,

Në prani të të gjithë të pandehurve dhe avokatëve të tyre mbrojtës, si dhe të prokurorit, në bazë të nenit 359 paragrafi 1 i Kodit të procedurës penale të Republikës së Kosovës Nr. 04/L-123 (më tuutje "KPPK"), publikisht merr këtë:

AKTGJYKIM

1. **Të pandehurit N.V. dhe F.B., me të dhënat personale të lartëcekura, për veprat penale të Krimin të organizuar nga neni 274, paragrafët (1), (3) dhe (7) të Kodit penal të Kosovës (KPK 2003) dhe Shpërlarje parash nga neni 32 paragrafi (2) nënparagrafët (2.1), (2.4) dhe (2.5) të Ligjit për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit terrorist 2010, lidhur me nenin 23 të KPK 2003, për të cilat janë akuzuar në aktakuzë, janë:**

FAJTORE

Sepse nga 13 dhjetori 2011 deri në nëntor 2012, në Prishtinë, N.V. dhe F.B. kanë organizuar, themeluar, mbikëqyrur, menaxhuar dhe udhëhequr aktivitetet e një grupi të organizuar kriminal, i cili përbëhej nga ata vet, B.B., E.D., I.F. dhe N.T., një grup i cili ishte themeluar me qëllim të kryerjes së veprës penale Shpërlarje parash për të përfituar, në mënyrë të drejtpërdrejt dobi financiare dhe dobi tjera materiale për anëtarët e tij.

N.V., me qëllimin që të përfitojë një dobi materiale të paligjshme për vete dhe për persona tjerë, e ka mashtruar Ministrinë e punëve të brendshme (MPB) dhe Österreichische Staatsdruckerei GmbH (OeSD) nëpërmjet një prezantimi fals për numrin e xhirrollogarisë së saj në bankën NLB 1701001012075322 për shumën prej 1,420,255.13 Euro, e cila shumë është transferuar nga MPB e Kosovës dhe pastaj është përvetësuar në mënyrë të paligjshme. Paratë kanë qenë të destinuara si pagesë për OeSD sipas faturave të tyre për furnizim me pasaporta elektronike dhe makineri të cilat i janë dërguar MPBsë. Pasi i ka marrë këto para me mashtrim dhe, pasi i ka përzier ato me paratë e fituara në mënyrë të ligjshme, N.V. i ka tërhequr 470,953.87 EURO në bankomat dhe në para të gatshme, i ka shpenzuar 27,876.92 EURO për shpenzime tjera dhe, në bashklëveprim me F.B.N, në mënyrë të paligjshme i ka transferuar 669,000 EURO tek anëtarët tjerë të grupit të organizuar kriminal, shumat në vijim:

Pirro ShPK shumën prej 200,000.00 EURO më 14 dhjetor 2011

Ron Ing ShPK shumën prej 100,000.00 EURO më 19 dhjetor 2011

Ron Ing ShPK shumën prej 100,000.00 EURO më 23 dhjetor 2011

Qeramika LB Kosova ShPK shumën prej 100,000.00 EURO më 22 shkurt 2012

Qeramika LB Kosova ShPK shumën prej 100,000.00 EURO më 1 mars 2012

Construction Beton ShPK shumën prej 20,000.00 EURO më 1 mars 2012

Construction Beton ShPK shumën prej 49,000.00 EURO më 30 gusht 2012

Më tutje, në bashkëkryerje me F.B.n, N.V. ka transferuar në mënyrë të paligjshme përafërsisht 342,825 EURO, në mënyrë që të paguaj borxhet dhe shpenzimet e saj personale dhe ato të F.B.T, duke përfshirë blerjen e një apartamenti për 77,000 EURO për N.V.JN dhe 39,000 EURO për ndërmarrjen “Fimex” të F.B. Në bashkëkryerje me B.B.N, 20,000 EURO tjera i janë transferuar ndërmarrjes FIB Oil të B.B.T.

Përmes veprimeve të saj kriminale N.V., duke bërë një përfaqësim fals, ka përfituar një dobi material në shumën prej 1,420,255.13 Euro. Në bashkëkryerje me F.B.n, B.B.n, E.D.n, I.F. dhe N.T.n, N.V. i ka transferuar paratë me qëllimin që t’i fsheh natyrën, burimin dhe pronësinë e parave të vjedhura, duke realizuar në këtë mënyrë një dobi financiare substanciale për vete dhe për anëtarët e këtij grupi kriminal.

F.B., në bashkëkryerje me N.V.n dhe me pjesëmarrjen e anëtarëve tjerë të grupit të organizuar kriminal, ia ka transferuar shumën prej 669,000 EURO të parave të vjedhura të përshkuara më lartë Pirro ShPK, Qeramika LB Kosova ShPK, Ron Ing ShPK dhe Construction Beton ShPK. Më tej, në bashkëkryerje me N.V.N, F.B. i ka transferuar në mënyrë të paligjshme 342,825 EURO në mënyrë që të paguaj borxhet dhe shpenzimet personale të tij dhe të N.V.jt, duke përfshirë blerjen e një apartamenti për 77,000 EURO për N.V.N dhe 39,000 EURO për kompaninë “Fimex” të F.B.T. 20,000 EURO tjera i janë transferuar kompanisë FIB Oil të B.B.T. F.B. i nihte pronarët dhe drejtorët e kompanive në xhirollogaritë e të cilave ishin depozituar paratë e vjedhura.

F.B. e dinte se këto para ishin para të vjedhura. Trupi gjykues gjen se këto para rridhnin nga veprimtaria kriminale. Në bashkëkryerje me N.V.N, B.B.N, E.D.N, I.F. dhe N.T.N, F.B. i ka transferuar paratë me qëllimin që t’i fsheh natyrën, burimin dhe pronësinë e parave të vjedhura, duke realizuar në këtë mënyrë një dobi financiare substanciale për vete dhe për të tjerët.

Në këtë mënyrë, N.V. dhe F.B., sipas rikualifikimit juridik të bërë nga ana e gjykatës në bazë të nenit 360(2) të KPPK dhe në bazë të nenit 3 (2) të KPRK, kanë kryer veprën penale të Krimin të organizuar nga neni 274(3) i Kodit Penal të Kosovës (KPK 2003), lidhur me veprën penale Shpërlarje parash nga neni 32 paragrafi (2) nënparagrafi (2.1) i Ligjit për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin terrorist 2010, në lidhje me nenin 23 të KPK 2003.

2. Të pandehurit B.B., E.D., I.F. dhe N.T., me të dhëna personale të lartëcekura, për veprat penale të Krimin të organizuar, nga neni 274 (1), (2), (4) dhe (7) të KPK 2003 dhe Shpërlarje parash nga neni 32, paragrafi 2.1, 2.2, 2.4 dhe 2.5 i Ligjit për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin terrorist 2010, për të cilat janë akuzuar në aktakuzë, janë:

FAJTORË

Sepse të pandehurit B.B., E.D., I.F. dhe N.T. kanë kryer krimin e rëndë Shpërlarje parash si pjesë e një grupi të organizuar kriminal të menaxhuar dhe të udhëhequr nga ana e të pandehurve F.B. dhe N.V.. Në mënyrë specifike:

B.B., ishte pronar i Fib Oil dhe vëllai më i ri i të pandehurit F.B.. Më 14 dhjetor 2011, një ditë pasi që e pandehura N.V. i kishte pranuar transferet prej 738,240 eurove dhe 64,596 eurove nga MPB-ja, shuma prej 20,000 eurove është transferuar nga llogaria e Consulting EU, llogari me të cilën ka operuar N.V., në llogarinë bankare të FIB Oil. Ky transfer nuk ishte për blerjen e vajit për ngrohje, siç është pohuar nga i pandehuri. Ai ishte një trillim i nxjerrë për të maskuar qëllimin e vërtetë të transferit. Shuma prej 20,000 eurove ishin të ardhura nga krimi. B.B. e dinte se këto ishin të ardhura nga krimi. Ky transfer është bërë me qëllim të fshehjes dhe maskimit të natyrës, burimit dhe pronësisë së të ardhurave nga krimi. B.B. ka kryer krim të rëndë të shpërlarjes të parave si anëtar i një grupi të organizuar kriminal.

E.D. ishte formalisht personi i autorizuar në kompaninë Pirro SHPK dhe aksionar në Qeramika LB Kosova SHPK. Pirro është themeluar me 30 Tetor 2008. Ajo kishte qarkullim minimal. Qeramika është themeluar me 31 Janar 2012. E.D. ishte personi i cili *de facto*

kontrollonte llogaritë bankare të të dyja kompanive. Më 14 dhjetor 2011, shuma prej 200,000.00 eurove është transferuar nga llogaria e Consulting EU në llogarinë bankare të Pirro SHPK. Më 22 shkurt 2012, një transfer tjetër në shumë prej 100,000.00 eurove është bërë nga llogaria e Consulting EU në llogarinë bankare të Qeramika LB Kosova SHPK. Ky transfer është bërë vetëm 22 ditë pasi që ishte themeluar Qeramika. Më 1 mars 2012, E.D. e ka pranuar shumën tjetër prej 100,000.00 eurove në llogarinë bankare të Qeramika LB Kosova SHPK. Paratë janë transferuar nga llogaria bankare e Consulting EU SHPK, llogari me të cilën operonte N.V. Asnjë nga këto transfere nuk janë bërë për ndonjë qëllim të ligjshëm. Shuma prej 400,000 eurove ishin të ardhura nga krimi. E.D. e dinte se këto para ishin të ardhura nga krimi. Këto transfere janë bërë me qëllim të fshehjes dhe maskimit të natyrës, burimit dhe pronësisë së parave të vjedhura. I pandehuri E.D. ka kryer krim të rëndë të shpërlarjes së parave si pjesë e një grupi të organizuar kriminal.

I.F., ishte aksionar i kompanisë Ron ING dhe person i autorizuar për të operuar me llogarinë bankare të kësaj kompanie. Ron Ing është themeluar më 23 Prill 2010. Më 19 dhjetor 2011, shuma prej 100,000.00 eurove është transferuar në llogarinë e Ron Ing SHPK. Paratë janë transferuar nga llogaria bankare e Consulting EU SHPK, llogari me të cilën operonte N.V. Më 23 dhjetor 2011, një shumë tjetër prej 100,000.00 eurove është transferuar nga llogaria bankare e Consulting EU SHPK në llogarinë e Ron Ing. Asnjë nga këto transfere nuk janë bërë për ndonjë qëllim të ligjshëm. Shuma prej 200,000 eurove ishin të ardhura nga krimi. I.F. e dinte se këto para ishin të ardhura nga krimi. Këto transfere janë bërë me qëllim të fshehjes dhe maskimit të natyrës, burimit dhe pronësisë së parave të vjedhura. I pandehuri I.F. ka kryer krim të rëndë të shpërlarjes së parave si pjesë e një grupi të organizuar kriminal.

N.T., ishte personi që *de facto* e kontrollonte kompaninë Construction Beton SHPK, kompani e cila gjoja ishte në pronësi të djalit të tij A.T. Construction Beton është themeluar më 28 shkurt 2012. Më 1 mars 2012 – një ditë pasi që ishte themeluar – e pandehura N.V. e transferoi shumën prej 20,000 eurove nga llogaria bankare e Consulting EU SHPK në llogarinë e Construction Beton SHPK. Më tej, më 30 gusht 2012, një shumë prej 49,000 eurove është transferuar nga llogaria bankare e Consulting EU në llogarinë bankare të Construction Beton SHPK. Shuma prej 69,000 eurove ishin të

ardhura nga krimi. N.T. e dinte se paratë ishin të ardhura nga krimi. Paratë kanë kaluar nëpërmjet kompanisë së A.T., Construction Beton si pjesë e planit të të pandehurve N.V., F.B. dhe N.T. për të shpërlarë paratë e vjedhura. Këto transfere janë bërë me qëllim të fshehjes dhe maskimit të natyrës, burimit dhe pronësisë së parave të vjedhura. I pandehuri N.T. ka kryer krim të rëndë të shpërlarjes së parave si pjesë e një grupi të organizuar kriminal.

Në këtë mënyrë, të pandehurit B.B., E.D., I.F. dhe N.T., në pajtim me rikualifikimet ligjore të bëra nga gjykata në pajtim me nenin 360(2) të KPPK-së, dhe në pajtim me nenin 3 (2) të KPRK-së, e kanë kryer veprën penale të krimit të organizuar sipas nenit 274(1) të KPK-së 2003, në lidhje me veprën penale të shpërlarjes së parave sipas nenit 32 paragrafi (2) nën-pikat (2.1) e Ligjit për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe të Financimit të Terrorizmit 2010, në lidhje me nenin 23 të KPK-së (2003).

- 3. E pandehura N.V., me të dhënat personale të përmendura më lartë, për sa i përket veprës së mashtrimit sipas nenit 261, paragrafët (1) dhe (2) të KPK-së 2003, me të cilën ajo akuzohet në aktakuzë është:**

FAJTORE

Sepse në nëntorin e vitit 2011 dhe më 6 dhjetor 2011, në Prishtinë, e pandehura N.V. i ka marrë disa autorizime me shkrim nga OeSD-ja me anë të e-mailit të cilat ajo i paraqiste te OeSD-ja se nevojiteshin për qëllim të transportimit dhe shpërndarjes së makinerisë dhe pasaportave elektronike nëpërmjet të doganave tek MPB-ja. Në veçanti, e pandehura N.V. e ka mashtruar OeSD-në se autorizimi me shkrim i datës 6 dhjetor 2011, kishte nevojë për fjalët “të gjitha detyrat financiare të OeSD-së në Kosovë procedohen nga përfaqësuesja jonë zyrtare” dhe numri i llogarisë së saj në bankën NLB për të cilën ajo insistonte në mënyrë të rreme se ishte e domosdoshme për tu marrë me të gjitha çështjet doganore dhe për pjesët rezervë për makinerinë. Ajo pastaj i mashtroi përfaqësuesit e MPB-së se ky autorizim i veçantë i ka dhënë asaj kompetencë për të pranuar të gjitha paratë e faturave për OeSD-në si përfaqësuese e tyre vendore, gjë e cila ishte krejtësisht e pavërtetë. Më tej, pa lejen e OeSD-së, N.V. në mënyrë mashtruese

i ka ndryshuar faturat e OESD-së duke arritur shumën totale prej 3,410,343.91 eurove duke e shtuar kompaninë e saj, Consulting EU (CE) dhe numrin e llogarisë së saj bankare në vlerat më të ulëta të faturave. Në mes të nëntorit 2011 dhe shtatorit 2012, ajo me qëllim e ka fshehur nga OeSD-ja faktin se ajo i ka bërë këto ndryshime dhe e ka mashtruar OeSD-në duke e bërë të besojë se MPB-ja ka dështuar që t'i paguajë faturat. Duke i kryer këto akte mashtruese ajo e ka arritur një fitim material të paligjshëm prej 1,420,255.13 eurove.

Andaj, N.V. e ka kryer veprën penale të mashtrimit në pajtim me nenin 3 (2) të KPRK-së dhe nenin 261, paragrafët (1) dhe (2) të KPK-së 2003.

4. E pandehura N.V., me të dhënat personale të përmendura më lartë, **LIROHET** për sa i përket veprave të **keqpërdorimit të besimit sipas nenit 269 të KPK-së 2003, me të cilën ajo akuzohet në aktakuzë, në pajtim me nenin 364(1) (1.1) të KPPK-së, sepse akti për të cilin e akuzuar ngarkohet në aktakuzë nuk përbën veprë penale të keqpërdorimit të besimit.**
5. Të pandehurit N.V., F.B., E.D., I.F., N.T., J.B. dhe S.S., në pajtim me nenin 364(1) (1.1) të KPPK-së **LIROHEN** nga akuza e kryerjes së veprës penale të **SHMANGIES NGA TATIMI, sipas nenit 63 (1), (2) (2.1), (3) dhe (4) të Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat (ATP), sepse aktet për të cilat ngarkohen të akuzuarit nuk e përbëjnë veprën penale të shmangies nga tatimi.**
6. **J.B., me të dhënat personale të përmendura më lartë, për sa i përket veprës penale të pranimit të mallrave të vjedhura sipas nenit 272, paragrafët (1) dhe (2) të KPK-së 2003, me të cilën ai akuzohet në aktakuzë është:**

FAJTOR

Sepse i pandehuri J.B. e formoi kompaninë Qeramika LB Kosova SHPK, me 31 Janar 2012 me bashkëpronar të pandehurin E.D.. Më 22 shkurt 2012, Qeramika LB Kosova SHPK e pranoi një transfer prej 100,000 eurove nga llogaria bankare e Consulting EU SHPK, llogari me të cilën operonte N.V.. Më 1 mars 2012, shuma tjetër prej 100,000 eurove

është transferuar nga llogaria bankare e Consulting EU SHPK në llogarinë bankare të Qeramika LB Kosova SHPK. Më 16 mars 2012, shuma prej 135,000 eurove është transferuar prej E.D.T nga llogaria bankare e Qeramika LB Kosova SHPK në llogarinë bankare të Pirro SHPK, me të cilën operonte E.D. Këto transfere nuk janë bërë për ndonjë qëllim të ligjshëm. J.B. e dinte se shuma prej 200,000 eurove është arritur me kryerjen e një veprë penale. Ai i mori paratë për përfitimin e tij financiar. Nga këto para, J.B. i bëri disa tërheqje për shfrytëzim personal duke e arritur shumën e përgjithshme prej rreth 24,000 eurove. Një pjesë e të ardhurave nga vepra penale është shfrytëzuar për blerjen e një banese, specifikisht banesa B/1, Kati 8, me sipërfaqe 66.2 m² në ndërtesën e quajtur si ndërtesa A1 dhe sipas planit është banesa 2B+p+8+NK, Blloku A11, Mati I, Prishtine, Kosove, me vlerën prej rreth 45,000 eurove.

NË KËTË MËNYRË duke e kryer veprën penale të pranimit të mallrave të vjedhura në pajtim me nenin 3 (2) të KPRK-së dhe sipas nenit 272 (1) të KPK-së 2003.

7. **S.S., me të dhënat personale të përmendura më lartë, për sa i përket veprës së pranimit të mallrave të vjedhura sipas nenit 272, paragrafët (1) dhe (2) të KPK-së 2003, me të cilën ai akuzohet në aktakuzë është:**

FAJTOR

Sepse i pandehuri S.S. është pronar i Ron Ing. Ai ishte i vetëdijshëm se kompania e tij Ron Ing i kishte pranuar 100,000 euro më 19 dhjetor 2011 dhe një shumë tjetër prej 100,000 eurove më 23 dhjetor 2011. Që të dyja transferet janë bërë nga llogaria bankare e Consulting EU SHPK, kompani e cila ishte në pronësi dhe operohej nga N.V.. Këto transfere nuk ishin bërë për ndonjë qëllim të ligjshëm. S.S. e dinte se paratë ishin të ardhura nga krimi. Ai i mori paratë për përfitimin e tij financiar. S.S. i ka tërhequr 37,000 euro nga këto para.

NË KËTË MËNYRË duke e kryer veprën penale të pranimit të mallrave të vjedhura në pajtim me nenin 3 (2) të KPRK-së dhe nenit 272 (1) të KPK-së 2003.

8. **H.S.**, me të dhënat personale të përmendura më lartë, në pajtim me nenin 364(1) (1.1) të KPPK-së **LIROHET** nga akuza e kryerjes së veprës penale të **shmangies nga tatimi, sipas nenit 63 (1) dhe (4) të Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat 2010 (ATP)**, sepse akti për të cilin ngarkohet i akuzuari nuk e përbënë veprën penale të shmangies nga tatimi.

PRANDAJ,

9. **N.V.** pasi që është dënuar për veprën penale të krimit të organizuar sipas nenit 274 (3) të KPK-së 2003, në lidhje me veprën penale të shpërlarjes së parave sipas nenit 32, paragrafi (2) nën-pika (2.1) e Ligjit për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe të Financimit të Terrorizmit 2010, në lidhje me nenin 23 të KPK-së (2003), në pajtim me nenin 3 (2) të KPRK-së, sipas nenit 274 (3) të KPK-së 2003 dënohet me burgim në kohëzgjatje prej **njëmbëdhjetë (11) viteve** dhe me një gjobë prej njëzetepesëmijë **(25,000) eurove** dhe me **burgim prej 4 (katër) viteve** dhe me një gjobë prej njëmijë (1,000) eurove për kryerjen e veprës penale të mashtrimit sipas nenit 261, paragrafi (2) i KPK-së 2003 dhe nenit 39(1) të KPK-së 2003.

Andaj, e pandehura N.V., në pajtim me nenin 71, paragrafi 1, 2.2 dhe 2.4 i KPK-së 2003, dënohet me dënim unik prej **12 (dymbëdhjetë) vjetëve burgim dhe me gjobë prej 25,000 eurove**. Koha e kaluar në paraburgim nga data 14 nëntor 2012 i llogaritet në dënimin unik. Në pajtim me nenin 39(2) të KPK-së 2003, afati i fundit për pagesën e gjobës nga e pandehura është gjashtë (6) muaj nga plotfuqishmëria e aktgjykimit.

10. **F.B.** pasi që është dënuar për veprën penale të krimit të organizuar sipas nenit 274 (3) të KPK-së 2003, në lidhje me veprën penale të shpërlarjes së parave sipas nenit 32, paragrafi (2) nën-pika (2.1) e Ligjit për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe të Financimit të Terrorizmit 2010, në lidhje me nenin 23 të KPK-së (2003), në pajtim me nenin 3 (2) të KPRK-së, sipas nenit 274 (3) të KPK-së 2003 dënohet me burgim në kohëzgjatje prej **njëmbëdhjetë (11) vjetëve** dhe gjobë prej njëzetepesëmijë **(25,000) eurove**. Koha e kaluar në arrest shtëpiak që nga data 14 Nentor 2012 do të llogaritet në dënimin e shpërndarë. Në pajtim me nenin 39(2) të KPK-së 2003, afati i fundit për

pagesën e gjobës nga i pandehuri është gjashtë (6) muaj nga plotfuqishmëria e aktgjykimit.

11. B.B. pasi që është dënuar për veprën penale të krimit të organizuar sipas nenit 274 (1) të KPK-së 2003, në lidhje me veprën penale të shpërlarjes së parave sipas nenit 32, paragrafi (2) nën-pika (2.1) e Ligjit për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe të Financimit të Terrorizmit 2010, në lidhje me nenin 23 të KPK-së (2003), në pajtim me nenin 3 (2) të KPRK-së, sipas nenit 274 (1) të KPK-së 2003 dhe nenit 66(2) dhe nenit 67(1.2) të KPK-së 2003, dënohet me **5 (pesë) vjet burgim** dhe gjobë prej **10,000 eurove**. Koha e kaluar në arrest shtëpiak që nga data 14 Nëntor 2012 do të llogaritet në dënimin e shpërndarë. Në pajtim me nenin 39(2) të KPK-së 2003, afati i fundit për pagesën e gjobës nga i pandehuri është gjashtë (6) muaj nga plotfuqishmëria e aktgjykimit.

12. E.D. pasi që është dënuar për veprën penale të krimit të organizuar sipas nenit 274 (1) të KPK-së 2003, në lidhje me veprën penale të shpërlarjes së parave sipas nenit 32, paragrafi (2) nën-pika (2.1) e Ligjit për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe të Financimit të Terrorizmit 2010, në lidhje me nenin 23 të KPK-së (2003), në pajtim me nenin 3 (2) të KPRK-së, sipas nenit 274 (1) të KPK-së 2003, dënohet me **8 (tetë) vjet burgim** dhe gjobë prej **20,000 eurove**. Në pajtim me nenin 39(2) të KPK-së 2003, afati i fundit për pagesën e gjobës nga i pandehuri është gjashtë (6) muaj nga plotfuqishmëria e aktgjykimit.

13. I.F. pasi që është dënuar për veprën penale të krimit të organizuar sipas nenit 274 (1) të KPK-së 2003, në lidhje me veprën penale të shpërlarjes së parave sipas nenit 32, paragrafi (2) nën-pika (2.1) e Ligjit për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe të Financimit të Terrorizmit 2010, në lidhje me nenin 23 të KPK-së (2003), në pajtim me nenin 3 (2) të KPRK-së, sipas nenit 274 (1) të KPK-së 2003 dhe nenit 66(2) dhe nenit 67(1.2) të KPK-së 2003, dënohet me **5 (pesë) vjet burgim** dhe gjobë prej **8,000 eurove**. Në pajtim me nenin 39(2) të KPK-së 2003, afati i fundit për pagesën e gjobës nga i pandehuri është gjashtë (6) muaj nga plotfuqishmëria e aktgjykimit.

- 14. N.T.** pasi që është dënua për veprën penale të krimit të organizuar sipas nenit 274 (1) të KPK-së 2003, në lidhje me veprën penale të shpërlarjes së parave sipas nenit 32, paragrafi (2) nën-pika (2.1) e Ligjit për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe të Financimit të Terrorizmit 2010, në lidhje me nenin 23 të KPK-së (2003), në pajtim me nenin 3 (2) të KPRK-së, sipas nenit 274 (1) të KPK-së 2003 dhe nenit 66(2) dhe nenit 67(1.2) të KPK-së 2003, dënohet me **4 (katër) vjet burgim** dhe gjobë prej **8,000 eurove**. Në pajtim me nenin 39(2) të KPK-së 2003, afati i fundit për pagesën e gjobës nga i pandehuri është gjashtë (6) muaj nga plotfuqishmëria e aktgjykimit.
- 15. J.B.** dënohet me **1 (një) vit burgim** dhe me gjobë prej **5,000 EURO** për kryerjen e veprës penale të Pranimit të sendeve të vjedhura sipas nenit 3 (2) të KPRK, nga neni 272 (1) dhe në bazë të nenit 39(1) të KPK 2003. Në bazë të nenit 39(2) të KPK 2003, afati për pagesën e gjobës nga ana e të pandehurit është gjashtë (6) muaj pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- 16. S.S.** dënohet me **1 (një) vit burgim** dhe me gjobë prej **5,000 EURO** për kryerjen e veprës penale të Pranimit të sendeve të vjedhura sipas nenit 3 (2) të KPRK, nga neni 272 (1) dhe neni 39(1) i KPK 2003. Në bazë të nenit 39(2) të KPK 2003, afati për pagesën e gjobës nga ana e të pandehurit është gjashtë (6) muaj pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- 17.** Në bazë të nenit 463(1) dhe (2) të KPPK, N.V. dhe F.B. janë të detyruar që bashkarisht dhe ndaras t'ia kompenzojnë palës së dëmtuar shumën prej 1,420,255.13 EURO, përcaktimi i së cilës mund të jetë objekt i procedurave civile. Kompenzimi do të paguhet brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- 18.** Në bazë të nenit 463(1) dhe (2) të KPPK, B.B. është i detyruar që bashkarisht dhe ndaras me N.V. dhe F.B. ta kompenzojnë palën e dëmtuar të lartpërmendur në shumën prej 20,000 EURO. Kompenzimi do të paguhet në gjykatë brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.
- 19.** Në bazë të nenit 463(1) dhe (2) të KPPK E.D. dhe J.B. janë të detyruar që bashkarisht dhe ndaras me N.V. dhe F.B. ta kompenzojnë palën e dëmtuar të lartpërmendur në shumën

prej 400,000 EURO. Kompenzimi do të paguhet në gjykatë brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

20. Në bazë të nenit 463(1) dhe (2) të KPPK I.F. dhe S.S. janë të detyruar që bashkarisht dhe ndaras me N.V. dhe F.B. ta kompenzojnë palën e dëmtuar të lartpërmendur në shumën prej 200,000 EURO. Kompenzimi do të paguhet në gjykatë brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

21. Në bazë të nenit 463(1) dhe (2) të KPPK, N.T. është i detyruar që bashkarisht dhe ndaras me N.V. dhe F.B. ta kompenzojnë palën e dëmtuar të lartpërmendur me shumë prej 69,000 EURO. Kompenzimi do të paguhet në gjykatë brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

22. Administrata Tatimore e Kosovës, e cila është referuar si palë e dëmtuar mund të ushtrojë kërkesat e saj kundër cilitdo të pandehur në procedura civile apo administrative.

23. Mbi konfiskimin e dobive materiale nga kryerja e veprave penale do të lëshohet një urdhër i veçantë.

24. Lidhur me shpenzimet e procedurës penale do të lëshohet një aktvendim i veçantë.

Kryetari i trupit gjykues
Gjyqtari i EULEX-it Malcolm Simmons

Procesmbajtës
Nuhi Shala

KËSHILLA JURIDIKE: Personat e autorizuar (të pandehurit, prokurori dhe pala e dëmtuar) mund t'i paraqesin ankesë kundër këtij aktgjykimi Gjykatës së Apelit përmes kësaj gjykate. Ankesa mund të parashtrohet brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e dorëzimit të një kopje e këtij aktgjykimi.